



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 21728  
Datë: 20/9/2024

Senati i Universitetit të Prishtinës, në bazë të nenit 20 të Statutit të Universitetit të Prishtinës, në bazë të nenit 73 të Statutit të UP-së, nenit 91 të Statutit dhe nenit 100 të Statutit, si dhe nenit 7 të Rregullores për studimet e doktoratës nr.937, dt. 26.4.2023, në mbledhjen e mbajtur me datë **18.09.2024**, shpall:

## KONKURS

*për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës në vitin akademik 2024/25*

1. Universiteti i Prishtinës në studimet e doktoratës për vitin akademik 2024/2025 do të pranojë deri në **42** studentë, në katër (4) programe studimore në kuadër të tre (3) fakulteteve.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12%, përkatësisht deri në pesë (5) studentë të rregullt nga komuniteti joshumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti joshumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve.

Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet joshumicë 12%	Gjithsej
<b>FIEK</b>	<b>11</b>	<b>1</b>	<b>12</b>
Studime të doktoratës në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike PHD 180ECTS (A)	11	1	12
<b>Fakulteti i Mjekësisë</b>	<b>18</b>	<b>2</b>	<b>20</b>
Programi Mjekësi Paraklinike	9	1	10
Programi Mjekësi Klinike	9	1	10
<b>Fakulteti i Edukimit</b>	<b>9</b>	<b>1</b>	<b>10</b>
Doktoratë në Shkencat e Edukimit (Program i përbashkët/ Doktoratë e dyfishtë) sipas orientimeve më poshtë:			
Mësimdhënia dhe të nxënit (mësimdhënie të gjuhës dhe letërsisë shqipe, mësimdhënie të matematikës, mësimdhënie të shkencave të natyrës, mësimdhënie të teknologjisë dhe TIK-ut, mësimdhënie të shkencave shoqërore)	6	1	7
Politikat arsimore	1	0	1
Edukimi në fëmijërinë e hershme	2	0	2
<b>GJITHSEJ</b>	<b>38</b>	<b>4</b>	<b>42</b>

## I. KUSHTET E KONKURSIT

- (1) Të drejtë konkurrimi për regjistrim në studimet e doktoratës kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet në fakultetet, respektivisht programet përkatëse.
- (2) Në studimet e doktoratës nuk mund të regjistrohen të diplomuarit me master profesional.
- (3) Kandidatët me të drejtë aplikimi në konkurs duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:
  - 3.1. Kandidatët me notë mesatare jo më të ulët se 8.00 në secilin nivel të studimeve paraprake veç e veç (për t'u llogaritur e vlefshme nota mesatare 8.00 e më lart në secilin nivel të studimeve, diplomat duhet të jenë të fituara së pari në nivelin baçelor e më pastaj në nivelin master).
  - 3.2. Të diplomuarit para hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës, të cilët duhet të jenë magjistra të shkencës përkatëse;
  - 3.3. Të diplomuarit pas hyrjes në fuqi të studimeve sipas Deklaratës së Bolonjës – niveli i studimeve master shkencor;
  - 3.4. Të diplomuarit në studime të integruara që kanë së paku 300 kredi EuropeanCreditTransferSystem (ECTS);
- (4) Kriteret e përcaktimit të përparësisë në radhitje përzgjedhëse janë:
  - 4.1. Kandidatët duhet t'i kenë të përfunduara studimet paraprake në njësinë akademike përkatëse, në fushën e njëjtë ose të afërt me studimet e doktoratës. Fushat e afërta përcaktohen nga njësia akademike përkatëse, vlejné për tërë periudhën e akreditimit të programit përkatës dhe publikohen në konkurs në kuadër të kushteve të veçanta në njësinë akademike përkatëse. Vlerësimi i fushave të kandidatëve të cilët studimet i kanë kryer në fakultetet ose universitetet tjera, bëhet nga ana e Këshillit të studimeve të doktoratës, para se të njëjtit t'i nënshtrohen provimit pranues.
  - 4.2. Nota mesatare gjatë studimeve në nivelet baçelor dhe master, përkatësisht nota mesatare e studimeve të integruara, vlerësohet maksimalisht me 30 pikë, të cilat llogariten duke shumëzuar notën mesatare aritmetike të studimeve baçelor dhe master me 3.
  - 4.3. Magjistratura nga lëmi shkencor ose specializimi relevant profesional vlerësohet me 5 pikë;
  - 4.4. Aktiviteti kërkimor - shkencor, siç dëshmohet me botimet dhe prezantimet si në vijim, vlerësohet me një vlerë maksimale deri në 15 pikë:
    - a) Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në WebofScience (SCIE, SSCI dhe AHCI) dhe/ose SCOPUS (Q1, Q2): autori i parë/korrespondent 5 pikë, të tjerët 2 pikë.
    - b) Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit dhe të indeksuar në SCOPUS (Q3, Q4) ose SCOPUS pa specifika të quartalit: autori i parë/korrespondent 4 pikë, të tjerët 1.5 pikë.
    - c) Për çdo artikull të botuar në pesë vjetët e fundit në revista të tjera ndërkombëtare të indeksuara në platformat e specifikuara në rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik: autori i parë 3 pikë, i dyti 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
    - d) Për çdo artikull të publikuar në pesë vjetët e fundit në revista akademike vendore, që botohen nga Universiteti i Prishtinës ose nga qendrat apo institutet e tij, nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, nga Instituti Albanologjik dhe nga Instituti i Historisë, të cilat i nënshtrohen recensionit profesional: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.

- e) Për libër universitar të botuar në pesë vjetët e fundit nga lëmi i ngushtë: autori kryesor 5 pikë, bashkautori 3 pikë gjithsej. Monografia në fushën ku aplikon kandidati vlerësohet me 4 pikë.
  - f) Për çdo prezantim gojor të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore, të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 2 pikë, të tjerët 1 pikë.
  - g) Për çdo prezantim në formë poster të punimit në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) ndërkombëtare shkencore, të indeksuar dhe të botuar në përmbledhjen e punimeve: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
  - h) Për çdo prezantim gojor në pesë vjetët e fundit në tubime (konferenca, kongrese, simpoziume) shkencore me karakter vendor: autori i parë 1 pikë, të tjerët 0.5 pikë.
- (5) Publikimet në revista dhe botues të dyshimtë, siç janë të definuar në rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me personelin akademik, nuk merren parasysh.
  - (6) Në rastin e pikëve të barabarta, përparësi i jepet kandidatit që është staf i rregullt i UP-së.
  - (7) Provimi pranues organizohet dhe administrohet nga njësitë akademike, duke respektuar standardet më të larta akademike. Në rastet e prezencës së konfliktit të interesit, duhet të evitohet në tersi përfshirja e personelit përkatës në të gjitha fazat e provimit pranues.
  - (8) Komisioni pranues do të emërohet nga Këshilli i njësisë përkatëse akademike.
  - (9) Kandidatët kanë të drejtë t'i nënshtrohen provimit pranues, vetëm nëse paraprakisht komisioni përkatës i fakultetit konstaton se i plotësojnë kushtet e konkursit dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e kompletuar.
  - (10) Provimi pranues përfshin provimin lidhur me aspektin profesional/shkencor dhe provimin lidhur me nivelin e njohjes së gjuhës angleze.
  - (11) Nga pjesa profesionale e provimit pranues kandidatët mund të fitojnë maksimalisht 30 pikë.
  - (12) Pjesa e provimit pranues lidhur me gjuhën angleze është e njëjtë për të gjitha njësitë akademike dhe është e obligueshme për të gjithë kandidatët. Çdo kandidat duhet të dëshmojë zotërim të gjuhës angleze së paku në nivelin B2. Kandidatët të cilët kanë dëshmi nga testet e njohura ndërkombëtarisht, TOEFL dhe IELTS- që janë administruar nga institucione të akredituara sipas kornizës së përbashkët evropiane të referencës për gjuhët (CEFR)- duhet të dëshmojnë që kanë arritur këto rezultate: për TOEFL minimum 72 pikë, ndërsa për IELTS minimum 5.5. Me këto rezultate, kandidati/tja me automatizëm i merr 10 pikë. Shprehur me shifra, për TOEFL, 72-79=10 pikë, 80-87=15 pikë, mbi 88=20 pikë. Me shifra, për IELTS, 5.5=10 pikë, 6.0=15 pikë, mbi 6.5=20 pikë. Njohuria e gjuhës angleze vlerësohet maksimalisht me 20 pikë. Për kandidatët që nuk paraqesin dëshmi të TOEFL-it dhe IELTS-it, provimin pranues për gjuhën angleze në nivelin B2 e organizon universiteti, sipas orarit të shpallur me konkurs për pranim të studentëve të doktoratës.
  - (13) Kandidatët kanë të drejtë të renditen në listë pasi të kenë kaluar pragun e kalueshmërisë të provimit pranues, përkatësisht pasi të kenë arritur së paku 50% të pikëve të pjesës profesionale dhe 50 % të pikëve të pjesës lidhur me gjuhën angleze.
  - (14) Kushtet e veçanta për fakultetet specifike mbizotërojnë në raport me kushtet e përgjithshme, duke mos anashkaluar dispozitat e rregullores dhe marrëveshjet e partnerëve për programe të përbashkëta.

## II. KUSHTET E VEÇANTA TË KONKURSIT, TË PËRCAKTUARA NGA FAKULTETET PËRKATËSE

### FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE

1. Të drejtë aplikimi kanë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake, baçelor dhe master, në Inxhinieri Elektrike dhe Kompjuterike.

2. Nga pjesa profesionale e provimit pranues kandidatët mund të fitojnë maksimalisht 30 pikë (prej të cilave 18 pikë nga pjesa me shkrim dhe 12 pikë nga prezantimi para komisionit përkatës):

2.1 Provimi me shkrim – nga metodologjia e hulumtimit shkencor dhe shkencave të inxhinierisë elektrike dhe kompjuterike. Kjo pjesë vlerësohet me 18 pikët e parapara nga provimi pranues.

2.2 Koncepti ideor – të jetë max 3 faqe A4, fonti 12, pa hapësira dhe të përmbajë: përshkrimin e problemit hulumtues, bazuar në literaturë të publikuar në revista prestigjioze, pyetjet hulumtuese, metodologjinë hulumtuese, një plan të hulumtimit, si dhe referencat përkatëse. Ky koncept, së bashku me prezantimin me gojë, vlerësohet me 12 pikë të parapara të provimit pranues.

### FAKULTETI I MJEKËSISË

#### 1. Programi Mjekësi Klinike

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët, të cilët kanë përfunduar studimet në drejtimin *Mjekësi e Përgjithshme*.

#### 2. Programi Mjekësi Paraklinike

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët, të cilët kanë përfunduar studimet në drejtimin *Mjekësi e Përgjithshme, Stomatologji dhe Farmaci*.

Kandidatët, për pjesën profesionale, do t'i nënshtrohen provimit për njohuritë *nga fusha e Metodologjisë së punës shkencore*.

Kandidati/ja në programet e doktoratës në Fakultetin e Mjekësisë duhet të dorëzojë *konceptin ideor të hulumtimit* origjinal në fushën përkatëse të programit të doktoratës që aplikon.

Përmes *konceptit ideor të hulumtimit*, kandidati artikulon idenë hulumtuese, vizionin dhe metodologjinë e tij/saj për zhvillimin e një projekti hulumtues në një fushë ose temë specifike të drejtimit përkatës. Koncepti ideor i hulumtimit duhet të përmbajë hyrjen me artikullimin e problemit hulumtues dhe mbështetjen me literaturë të publikuar në revista prestigjioze, pastaj rëndësinë shkencore të konceptit ideor të hulumtimit, qëllimet, hipotezat dhe metodologjinë e përmbledhur, me të cilën planifikohet ai hulumtim, si dhe literaturën (së paku 10 referenca përkatëse).

Në aspektin teknik, ky propozim duhet të paraqitet përmes një teksti të shkruar prej më së shumti 3 faqeve të programit *Word*, me madhësi shkronjash nr.12 dhe pa hapësira midis rreshtave.

## FAKULTETI I EDUKIMIT

Programi i Doktoratës në Shkencat e Edukimit është një program i përbashkët me Universitetin e Lubjanës, Fakultetin e Edukimit sipas formës 'Diplomë e dyfishtë', i cili ofrohet në gjuhën angleze. Prandaj, parakusht për të aplikuar në këtë program është dëshmia nga testet e njohura ndërkombëtarisht, TOEFL dhe IELTS, që janë administruar nga institucionet e akredituara sipas kornizës së përbashkët evropiane të referencës për gjuhët (CEFR) me minimum 79 pikë për TOEFL dhe minimum 5.5 pikë për IELTS. Përfundim nga kjo kërkesë bëjnë kandidatët që kanë kryer studimet master të ofruara në gjuhën angleze.

1. Provimi pranues:
  - a) 30 pikë nga testi i metodologjisë së hulumtimit shkencor dhe shkencave të edukimit.
  - b) 20 pikë nga prezantimi i konceptit ideor të hulumtimit, i cili duhet të dorëzohet në kohën e aplikimit. Ky koncept përfshin arsyeshmërinë e hulumtimit dhe metodologjinë e hulumtimit të propozuar (jo më gjatë se tri faqe).
2. Orientimi në program: Parimi bazë është që duhet të ekzistojë vazhdimësia e studimeve master në raport me orientimet e ofruara brenda këtij programi të doktoratës, duke përfshirë profilin e programit master dhe temën e masterit. Studenti mund të zgjedhë njërin nga orientimet si më poshtë:
  - Mësimdhënia dhe të nxënit: mund të orientohen të kualifikuarit master në fusha lëndore (akademike dhe arsimore) të gjuhës dhe letërsisë shqipe, matematikës, shkencave të natyrës, teknologjisë dhe TIK-ut, shkencave shoqërore.
  - Politikat arsimore: mund të orientohen të diplomuarit nga programet e menaxhimit ose udhëheqjes arsimore dhe pedagogjisë.
  - Edukimi në fëmijërinë e hershme: mund të orientohen të diplomuarit nga fusha e edukimit të hershëm, mësimdhënies dhe kurrikulës, pedagogjisë dhe psikologjisë, që fokus kanë pasur studimin e edukimit dhe zhvillimit në fëmijërinë e hershme.

### III. DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR APLIKIM

Parakusht për vlerësimin e kandidatëve është dorëzimi i dokumentacionit origjinal si në vijim:

1. Certifikatën ose ekstraktin e lindjes (jo më të vjetër se gjashtë - 6 muaj);
2. Diplomën dhe certifikatën e notave (origjinale ose të noterizuara) nga nivelet e studimeve paraprake në studimet baçelor, master ose magjistratura shkencore, ndërsa për Fakultetin e Mjekësisë diplomën dhe certifikatën e notave nga niveli i studimeve themelore (5-6 vjeçare);
3. Kandidatët që kanë kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës duhet t'i nënshtrohen njohjes së diplomës, me qëllim vazhdimin e studimeve, duke ndjekur procedurën sipas Statutit të Universitetit të Prishtinës;
4. Biografinë;
5. Letrën motivuese (në të cilën arsyetohet interesi për kërkime shkencore/artistike në lëmin përkatës);

6. Konceptin ideor të hulumtimit;
7. Rekomandimet e dy profesorëve nga lëmi përkatës;
8. Dëshmitë (origjinale ose të noterizuara) për njohjen e gjuhës angleze (nëse posedojnë certifikatë ndërkombëtare TOEFL me së paku 79 pikë ose IELTS me së paku 5.65 pikë);
9. Dëshmitë lidhur me publikimet/prezantimet nga veprimtaria kërkimore-shkencore (nëse posedojnë).

Paraqitja e dokumenteve të kompletuara bëhet në fakultetet përkatëse në formë fizike dhe përmes aplikimit elektronik, në adresën: [apliko.uni-pr.edu](mailto:apliko.uni-pr.edu)

#### IV. AFATET E KONKURSIT

- a) **Konkursi hapet nga data 20.09.2024 deri më 08.10.2024.**
- b) **Pjesa profesionale e provimit pranues** mbahet me datë **14.10.2024**, në orën **09:00**. Informatat për sallat e mbajtjes së provimit pranues, do të publikohen në ueb faqe të fakultetit përkatës.
- c) **Pjesa e provimit pranues lidhur me njohjen e gjuhës angleze** organizohet më **15.10.2024**, në orën **09:00**, në **Fakultetin e Filologjisë**. Informata për sallat e mbajtjes së provimit do të publikohen në ueb faqe të fakultetit.
- d) **Rezultati preliminar:** do të shpallet me datë **16.10.2024**, deri në orën **12:00**.
- e) **Ankesat e kandidatëve** do të pranohen me datën **17.10.2024** dhe **18.10.2024**, deri në orën **16:00**. Ankesat për provimin profesional bëhen në fakultetin përkatës, ku është realizuar provimi, ndërsa për provimin e gjuhës angleze bëhen në Fakultetin e Filologjisë. Ankesat e kandidatëve shqyrtohen nga komisioni për ankesa i njësisë përkatëse akademike.
- f) **Rezultati përfundimtar:** Njësitë përkatëse akademike, pas shqyrtimit të raportit të komisionit të ankesave, hartojnë listat e kandidatëve të propozuar në nivel të njësisë akademike dhe deri më **22.10.2024** i dërgojnë për shqyrtim në Këshillin Qendror të Studimeve të Doktoratës. Senati i Universitetit, bazuar në propozimin e njësisë akademike dhe Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës, merr vendim përfundimtar për pranimin e studentëve në studimet e doktoratës. Emrat e kandidatëve të pranuar, me të gjitha të dhënat e kriterëve të përzgjedhjes, shpallen publikisht në ueb faqen e njësisë akademike dhe në ueb faqen e universitetit.
- g) Data e regjistrimit të kandidatëve të pranuar do të publikohet pas vendimit përfundimtar të senatit.

